

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	20.01.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me aktivitetin e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të rinj, nisur nga rritja e çmimit të siguracionit të automjeteve.	30.01.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije informacioni i kërkuar është kompetencë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe për sa i përket Autoritetit të Konkurrencës ndër vite ka hetuar tregun e sigurimeve për produktin TPL dhe vazhdon ta ketë në monitorim këtë treg.	E plotë	Nuk ka
2.	31.01.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me rekomandimet që Komisioni i Konkurrencës i ka dhënë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare pas kqyrjes së tregut për produktin TPL.	04.02.2025	Kthim përgjigje, duke vënë në dispozicion vendimet e Komisionit të Konkurrencës për tregun e sigurimeve për produktin TPL.	E plotë	Nuk ka
3.	04.02.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me materiale për veprimtarinë e punës së	06.02.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se informacioni i kërkuar gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, në Programin e Transparencës, si dhe në	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		Autoritetit të Konkurrencës, si raporte vjetore, rezoluta të Kuvendit të Shqipërisë, materiale në kuadër të procesit të integritetit dhe të dhëna statistikore që burojnë në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.		seksionin “Të dhëna të hapura”, në zbatim të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.		
4.	07.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me hetimet e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024-2025, ligjin dhe rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe subjektet e hetuara.	18.03.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se të dhënat në lidhje me procedurat hetimore dhe subjektet e hetuara nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2024-2025, rregullorja dhe ligji mbi të cillin vepron institucioni, janë të publikuara në faqen zyrtare sipas linkut përkatës të vënë në dispozicion.	E plotë	Nuk ka
5.	07.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me ankesat e qytetarëve ndaj kompanive celulare dhe hetimin e nisur nga Autoriteti i Konkurrencës.	17.03.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se ndër vite Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar dhe hetuar tregun e shërbimeve celulare. Komisioni i Konkurrencës ka vendosur hapjen e hetimit paraprak për këto ndërmarrje në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, dhe në përfundim të procedurave hetimore, do të shprehet me vendim.	E plotë	Nuk ka
6.	12.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me situatën e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare.	17.03.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se ndër vite Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar dhe hetuar tregun e shërbimeve celulare. Komisioni i Konkurrencës ka vendosur hapjen e hetimit	E plotë	Nuk ka

				paraprak për këto ndërmarrje në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, procedura hetimore të cilat ende vijnë. Në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma (a) të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjëra në masën deri në 10% të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje që shkel nenet 4 dhe 9 të këtij ligji. Në lidhje me sanksionimin e ndërmarrjeve të shërbimeve celulare, aksesoni në faqen zyrtare Vendimin nr. 59, datë 09.11.2007.		
7.	19.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me hetimet e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2024-2025, ligjin dhe rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe subjektet e hetuara.	20.03.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije hetimet që ka realizuar Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2024. Është bërë me dije se AK, i cili vepron në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të fillojë një procedurë hetimore me nismën e tij apo me ankësë të palëve të interesuara ose të treta për kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me monitorimin, vlerësimin dhe hetimin e tregjeve. Për vitin 2025 janë marrë disa ankesa në lidhje me tregun e telefonisë celulare, për të cilin është hapur procedura e hetimit paraprak me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, i cili është i publikuar në faqen zyrtare sipas linkut përkatës të vënë në dispozicion, së bashku me	E plotë	Nuk ka

				rregulloren dhe ligjin mbi të cillin vepron institucioni.		
8.	21.03.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me kompanitë që janë hetuar nga 2023 deri sot, dëmi që kanë shkaktuar dhe masat e marra; humbjet financiare që kanë realizuar kompanitë në rastet e abuzimit me çmimet; audit i brendshëm; informacion mbi raportin e KLSH; informacion mbi kompanitë celulare; sugjerimet e bëra ndaj institucioneve të tjera për rregullimin e kuadrit ligjor, si dhe të dhëna mbi hetimin e tregut të fruta perimeve në Lushnje.	28.03.2025	Kthim përgjigje duke bërë me dije kompanitë që janë hetuar dhe gjobat e vendosura, të cilat janë gjithashtu të publikuara sipas vendimeve përkatëse në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës. Është sqaruar se AK nuk gjeneron të dhëna në lidhje me humbjet financiare që kanë realizuar kompanitë; institucioni në strukturën e tij nuk ka një audit të brendshëm dhe nuk bën sugjerime referuar ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nuk ka një dëm ekonomik të shkaktuar nga mosveprimi i institucionit referuar KLSH. Në lidhje me tregun e telefonisë celulare është bërë me dije se ky treg mbahet në monitorim të vazhdueshëm dhe se është hapur një hetim paraprak me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025. Gjithashtu edhe në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve është hapur një hetim. Për arsye se procedurat hetimore përsa i përket tregjeve të mësipërme janë ende në proces, AK nuk mund të japë informacion në këtë moment.	E plotë	Nuk ka
9.	25.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me vendimin e Birrës Stela tek Eurolab.	27.03.2025	Kthim përgjigje, duke vënë në dispozicion Vendimin nr. 1154, datë 29.01.2025, i cili është i publikuar në faqën zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, sipas linkut përkatës.	E plotë	Nuk ka
10.	01.04.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me zgjedhjen e	04.04.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në zbatim të nenit 21, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, emërimi i	E plotë	Nuk ka

		drejtuesit të institucionit.		drejtuesit të Autoritetit të Konkurrencës bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.		
11.	07.04.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e zgjedhjes së titullarit të institucionit.	11.04.2025	Kthim përgjigje, duke bërë sërish me dije se procedura e emërimit të titullarit të Autoritetit të Konkurrencës realizohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.	E plotë	Nuk ka
12.	16.04.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me përafrimin e kuadrit ligjor për fushën e konkurrencës me legjislacionin e BE-së.	22.04.2025	Kthim përgjigje duke bërë me dije se kuadri ligjor për fushën e konkurrencës, ku përfshihet ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe një sërë aktesh nënligjore, janë të përafruara gjerësisht me legjislacionin e BE-së, kryesisht me nenet 101 dhe 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian, si dhe Rregulloren e Bashkimit Europian për përqendrimet nr. 139/2004.	E plotë	Nuk ka
13.	27.05.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me rritjen e çmimit të kontratave nga kompanitë e telefonisë.	02.06.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës është duke kryer verifikimet përkatëse, dhe se kompanitë Vodafone Albania ShA dhe One Albania SHA janë nën hetim në bazë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1156, datë 29.01.2025.	E plotë	Nuk ka
14.	24.06.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me bazën ligjore të përdorur për ndryshimin e gjobës në rastin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë AMB Contruction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO	07.07.2025	Kthim përgjigje, duke vënë në dispozicion Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1017, datë 25.09.2023, si dhe Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	E plotë	Nuk ka

		TELECOM SHPK dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.				
15.	26.06.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me tregun e taksive.	03.07.2025	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se tregu i shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës ka qenë në hetim nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr. 661, datë 21.11.2019. Autoriteti i Konkurrencës do të fillojë procedurat hetimore, në rast se vihen re shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.	E plotë	Nuk ka
16.	22.12.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me tregjet që Autoriteti i Konkurrencës ka në hetim dhe monitorim, si dhe rezultatet e hetimeve të viteve të fundit, për sa i përket çmimeve të produkteve në fundvit.	30.12.2025	Kthim përgjigje, duke vënë në dispozicion informacionin e kërkuar në lidhje me monitorimet dhe hetimet e kryera nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2025.	E plotë	Nuk ka